Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshë lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr 020/64 - 46339 dt. 31/08 2022

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40,të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34,pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, bazuar në nenit 17, të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimit nr.02-463-38614, të datës 27.07.2022 për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë, Konfirmimi i ligjshmërisë Nr.020-654/10 i datës 16.08.2022 i vendimit 02-463-38614, të datës 27.07.2022, Kuvendi i Komunës së Drenasit-Glllogocit në mbledhjen e vetë të rregullit të mbajtur më 31.08. 2022 të miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

Neni 1

Miratohet Vendimi nga Kuvendi të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurta në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë dy (2) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, të cilët i propozon Kryetari i Komunës, dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës, nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal, si vijon:

1. Flutra Avdiu anëtar nga ekzekutivi,
2. Enver Hoxha anëtar nga ekzekutivi,
3. Qendrim Mula anëtar nga kuvendi,
4. Salih Dvorani anëtar nga kuvendi dhe
5. Arben Kuliqi anëtar nga sektori jo qeveritar.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit Vlerësues janë zbatimi i procedurave sipas nenit 19, të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 3

Komisioni vlerësues pas kryerjes së procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertën e përzgjedhur e procedon ashtu siç parashihen në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 19 të ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Ky vendim lypet në fuqi 15 ditë nga data e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit;



[Signature]
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministries of Local Government Administration

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovi, Kryetar i Komunës së Glogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glogocit
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Data: 17.09.2021 -VI-020-756
Zyrtaret përgjegjës:	Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për Monitorim të Komunave
Lënda:	Vlerësim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glogocit
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shërbetë afatgjatë në vitin 2022.

I miratuar më datë: 31.08.2021

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 01.09.2021

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në emër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:



Republika e Kosovës
Komuna Drenas (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës



Nr. 001/2021 dt. 31.08.2021

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, të Ligjit Nr.03 L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenin 13 të Ligjit Nr. 06 L-092, për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 31.08.2021, miratoi këtë

V E N D I M

Për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Glllogocit të miratoj listën së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022.

Neni 2

Pronat e paluajtshme të Komunës së Glllogocit të propozuara për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022, janë pjesë e këtij vendimi sipas listës së bashkangjitur.

Neni 3

Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë duhet të jetë në përputhje të plotë me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi. Dhënia e pronave të lartcekura në shfrytëzim afatgjatë, ka për qëllim zhvillimin ekonomik dhe interesin publik të komunës së Drenasit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPLSi dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi dërgohet:

- Zyres së Kryetarit ;
- Drejtorisë Perkatëse;
- Zyres së Kuvendit;
- Arkivit
- Palës



Kryesues i Kuvendit të Komunës

Edinot Halilaj



Republika e Kosovës
Kartografia dhe Harta (Shqipëri)
Kuvendi Komunal




Nr. 12.361/12.449 dt. 31.12.2021

Paraqitja tabelare e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Drenasit, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë gjatë vitit 2022

Nr.	NGASTRA KADASTRALE	SIPERFAQJA (m ²)	ZONA KADASTRALE	DESTINIMI (PZHK-Harta Zonale)
1	PIESE E PARCELES 726/15	13200	GLLOGOC	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
2	PIESE E PARCELES 4/111	26104	KOMORAN	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
3	00438/4	2559	GLLOBAR	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
4	00438/5	1838	GLLOBAR	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
5	00034/0	8128	Korridorë e Epërme	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
6	00878-5	4259	GLLOGOC	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
7	00758-1	1852	GLLOGOC	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
8	PIESE E PARCELES 00743/29	19815	GLLOGOC	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
9	PIESE E PARCELES 00414, 00430, 00435, 00435, 00434, 00433, 00431	5188	GLLOGOC	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
10	01981/0	3263	KOMORAN	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
11	00244/3	1930	KOMORAN	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
12	00244/4	2000	KOMORAN	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore

13	00244/S	1619	KOMOPAN	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
14	01980/S	2003	KOMOPAN	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
15	Pjesë e parcelës 02652/4	3232	ARLLAT	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
16	Pjesë e parcelës 140/0	21241	Polizhë	Tokë Bujqësore
17	Pjesë e parcelës 140/1	27063	Çikatovë e Re	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
18	Pjesë e parcelës 763/2	2044	Glllogoc	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
19	Pjesë e parcelës 767/2	2500	Glllogoc	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
20	Pjesë e parcelës 767/5	1639	Glllogoc	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
21	Pjesë e parcelës 726/17	57947	Glllogoc	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
22	1/8	1000	Komoran	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
23	1/13	1110	Komoran	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
24	Pjesë e parcelës 14/0	470707	Glllobar	Pyjore/Kulllosë
25	Pjesë e parcelës 768	1970	Glllogoc	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
26	144/0	9328	Çikatovë e Re	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinct Halila



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit



Nr 01-020/04-59612 dt. 15.11.2022

Komisioni i Ankesave i formuar sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr.02-020/04-49444, të datës 27.09.2022, në përputhje me Ligji Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke vendosur sipas ankesës Nr. 01-070/01-58983, të datës 10.11.2022, lidhur me njoftimin Publik Nr.01-462-53050, të datës 17.10.2022, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale, rrjedhimisht njoftimit të Komisionit Vlerësues për Vlerësimin e Ofertave për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për shpallje të fituesve të ofertave ekonomikisht me të favorshme Nr. 01-070-57805, të datës 04.11.2022, për parcelën kadastrale Nr.P-70314035-01987-0, në sipërfaqe 2075 m², në zonën kadastrale në Komoran, vendi i quajtur "Fusha Gjer-Fush Gjer", Komisioni i Ankesave, në takimin e datës 15.11.2022, mori këtë:

V e n d i m

Refuzohet si e pa bazuar ankesa Nr. 01-070/01-58983, e datës 10.11.2022, ndërsa njoftimi i Komisionit Vlerësues për Vlerësimin e Ofertave për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për parcelën kadastrale Nr.P-70314035-01987-0, në sipërfaqe 2075 m², në zonën kadastrale në Komoran, vendi i quajtur "Fusha Gjer-Fush Gjer", mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Komuna e Drenasit, respektivisht Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Drenasit, me datë 04.11.2022, ka bërë shpalljen e njoftimit publik Nr. 01-070-57805, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale.

Me datë 02.11.2022, komisioni ka bërë hapjen e ofertave për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite në komunën e Drenasit, me ofertuesit pjesëmarrës gjatë hapjes së ofertave.

Komisioni vlerësuar ka filluar me vlerësimin e ofertave me datë 04.11.2022, bazuar në Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullore (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe

Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, rrjedhimisht kriteret e përcaktuara sipas akteve të lartcekura.

Më datë 04.11.2022, Komisioni Vlerësues për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, shpall njoftimin për ofertat fituese Nr. 01-070-57805

Ofertuesi BB HOLDING L.L.C në Komoran, ka parashtruar ankesë Nr.01-070/01-58983, të datës 10.11.2022, kundër dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në të cilën ka kërkuar të anulohet njoftimi i datës 04.11.2022, për parcelën kadastrale Nr.P-70314035-01987-0, në sipërfaqe 2075 m², në zonën kadastrale në Komoran, vendi i quajtur "Fusha Gjer-Fush Gjer".

Komuna e Drenasit, rrjedhimisht Komisioni për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, me kohe ka publikuar të gjitha procedurat, kushtet dhe kriteret e parapara për shqyrtim me rastin e përzgjedhjes së ofertave ekonomikisht me të favorshme. Sipas komisionit të ankesave njoftimi është shpallur në përputhje me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke përfshi edhe kriteret shtesë të parapara në njoftimin publik, ashtu siç parashihet në nenin 20, nën pikën 1.1.5 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Sipas dokumentacionin të prezantuar ofertuesi BB HOLDING L.L.C në Komoran nuk e ka plotësuar kriterin e garancinë bankare i parapare sipas njoftimit publik Nr. 01-462-53050, të datës 17.10.2022 në kohëzgjatje prej 18 muajve, por ka dorëzuar sigurimin në kohëzgjatje për 5 muajve, po ashtu ofertuesi BB HOLDING L.L.C në Komoran nuk e ka plotësuar kriterin rreth pasqyrës financiare të Audituar për 5 vitet e fundit pasi që ka aplikuar në cilësinë e personit juridik.

Andaj, duke pasur parasysh nga të gjitha që u thanë me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur ka të drejtë të iniciojë kontestin administrativ në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Anëtarët e komisionit të ankesave

- 1.Armend Hajdini
- 2.Besart Bajrami
- 3.Zeqir Hasi
- 4.Hamit Haxhiu
- 5.Kaltrina Gashi



PËR : KOMISIONI PËR ANKESA PER DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

NGA : BB HOLLDING LLC me numër unik identifikues 811979551

Adresa: Rr Magjistralla Pejë – Prishtinë – Komaran

Tel: 00383 44 601 616

e-mail: b_gjoshi@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLUGLO			
GLLUGLO MUNICIPALITY			
Pranuar	10/11	20	22
Nj. Org.	Numër	Grupi	Vlera
01 - 070/01 58983			

Në pajtim me dispozitat e nenit 18 dhe 20 të Ligjit Nr. 06/L- për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, BB HOLLDING LLC me numër unik identifikues 811979551 në afatin ligjor parashtroi:

ANKESË

Kundër vlersimit të Komisionit vlerësues të Ofertave për Dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të publikuar në njoftimin e datës 04.11.2002, me nr. 01.070.57805 që ndërlidhet me Konkursin e datës 31.10.2022 me nr 01-nr.462-53050 për shkakt të:

- konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe
- aplikimit të gabuar të së drejtës material.

Komisioni vlerësues i Ofertave në njoftimin e publikuar, më datën 04.11.2002 me nr. 01.070.57805 që ndërlidhet me Konkursin e datës 31.10.2022 me nr 01-nr.462-53050 për Parcelën nr.P-70314035-01987-0 ka vlerësuar se kemi mungesë të dokumentacionit dhe me këtë rast Ofertën tonë nuk e ka rekomanduar për fitues. Vlerësimi i komisionit është i gabuar me konstatimin, se ne nuk kemi përmbushur dy nga kushtet: atë për Sigurimin e Garancionit të Ofertes dhe për Auditim e pasqyrave financiare.

~~Ne vlerësojmë se, Komisioni ka vlerësuar gabimisht gjendjen faktike dhe ka aplikuar gabimisht të drejtën material.~~

1. Sa i përket Garancionit të Sigurimit të ofertes prej 30 % (159.405.20) të vlerës investive prej 531.350 eurove , pra 30% 531.350 euro =159.405.20, ne kemi dorëzuar Polisën nr. 11/12 me kohëzgjatje prej 150 ditësh (afati maksimal që ekziston në bazë të Ligjit) bashkë me dokumentet tjera të kërkuara. Ne bashkë me këtë Ankese po ju percjellim edhe sqarimin nga Kompani e Sigurimit "Dukagjini" sh.a ,me të cilën dëshmohet se Garancioni i Ofertes është konform kushteve të Kërkesës së Konkursit dhe konform legjislacionit në fuqi

Garancioni i Ofertës siç është kërkuar në dokumentacion, në bazë të Legjislacionit në fuqi ka për qëllim që të garantohet nga pala që të mos tërhiqet nga Oferta. Komisioni ka ngatërruar Garancionin e Ofertës me Sigurimin e ekzekutimit . Sigurimi i Ekzekutimit kërkohej pas shpalljes së fitusit, pra me rastin e nënshkrimit të Kontratës.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, perkatesisht neni 57 e përcakton se çka është Garancioni i Ofertës dhe kur kërkohej dhe sipas nenin 63 se çka është Sigurimi i Ekzekutimit. Pra, Garancioni i Ofertës lëshohet nga garantuesi për llogari të kontraktuesit. Kontraktuesi do të sigurohet në vlerën e shumës së siguruar. Nëpërmjet kësaj Kontrate, garantuesi i detyrohet përfituesit deri në vlerën e shumës së siguruar, në qoftë se kontraktuesi i cili është pjesëmarrës në tender:

- Tërhiqet përpara zhvillimit të tenderit.
- Nuk e ka lidhur Kontratën brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertës, atëherë kur përzgjidhet si fitues.

Sigurimi i Ekzekutimit, është Kontratë e cila lidhet midis garantuesit dhe kontraktuesit dhe siguron përfituesin, në kushtet kur kontraktuesi nuk i plotëson detyrimet e tij kontraktuale kundrejt përfituesit dhe bën përmbushjen e detyrimeve të kontraktuesit, detyrime këto, të cilat i burojnë kontraktuesit nga Kontrata. Kjo kontratë lidhet me qëllim të forcimit të besimit mbi shlyerjen e detyrimeve të kontraktuesit ndaj përfituesit. Mbështetur në këtë Kontratë, garantuesi merr përsipër që të plotësojë çdo detyrim të kontraktuar, i cili është i përshkruar në këtë kontratë .

Pra nga këto argumente, mund të vertetohet se ne kemi dorëzuar Sigurimin e garncionit të Ofertës, në bazë të lgjeve në fuqi, dhe kjo lehtë është e e vertetushme.

Provë : Sqarimi i Kompanisë Dukagjini sha.

Informata nga faqja ne internet e kompanise

<https://www.illyriainsurance.com/sq-ko/insurance/business/guarantee/>

LIGJI Nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës

2. Sa i përket vlerësimit se gjoja se ne nuk kemi dorëzuar Pasqyrën e audituara, nuk qëndron ky vlerësim i Komisionit . Biznesi BB HOLLDDING LLC me numër unik identifikues 811979551 është biznes i ri, i themeluar me 25.10.2022, nga Bujar Gjoshi, me seli në Komoran Drenas. Si biznes i ri ende nuk ka krijuar ndonjë pasqyrë financiare dhe sipas Ligjit të Auditimit nuk mund t'i behet auditim financiar. Biznesi ka kapital themeltar në aksione prej 120.000 mije euro. Themeluesi i BB HOLLDDING LLC, në bazë të historiatit bankar të dorëzuar, dëshmohej se ka një qarkullim dhe një gjendje financiare të qendrueshme dhe të besueshme për investimin.

Ne kemi dorëzuar për këtë edhe deshminë e Auditorit të Pavarur Eco & Conto shpk si dhe historinë e bankes në kohëzgjatje 5(pesë) vjeçare të themelutit që dëshmon se ofertuesi ka qarkullim dhe kapacitet të mjaftueshem financiar .

Provë : Deshmia nga Auditori i Pavarur Eco & Conto .

Bazuar në gjithë sa u tha më sipër, duke u mbështetur në dispozita përkatëse ligjore, ankuesi me shumë respekt i kërkon Komisionit për Ankesa për dhënin në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, si organ kompetent për të trajtuar dhe vendosur meritueshëm, që të marrë këtë:

VENDIM

I. Aprovohet ankesa e ankuesit si e bazuar.


II. Ndryshohen Njoftimi i Komisionit vlersuses i Ofertave në njoftimin e datës 04.11.2002 me nr 01.070.57805 që ndërlidhet me Konkursin e datës 31.10.2022 me nr 01-nr.462-5305 për Parcelën nr.P-70314035-01987-0 dhe te shpallemi fitues i kësaj parcele për shfrytezim :

Kësaj Ankese ja bashkangjes dëshmitë;

- Njoftimi i datës 04.11.2002 me nr. 01.070.57805
- Njoftim i datës 31.10.2022 me nr. 01-nr.462-5305
- Polisa e Sigurimit
- Dokumentet e Biznesit

Kamaran, 8.11.2022

BB HOLLDDING LLC





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit



Nr. 01-020/04-59616 dt. 15.11. 2022

Komisioni i Ankesave i formuar sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr.02-020/04-49444, të datës 27.09.2022, në përputhje me Ligji Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke vendosur sipas ankesës përmes postes Nr. R 2590511, të datës 11.11.2022, lidhur me njoftimin Publik Nr.01-462-53050, të datës 17.10.2022, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale, rrjedhimisht njoftimit të Komisionit Vlerësues për Vlerësimin e Ofertave për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për shpallje të fituesve të ofertave ekonomikisht me të favorshme Nr. 01-070-57805, të datës 04.11.2022, për parcelën kadastrale Nr.P-70310515-00438-4, në sipërfaqe 2559 m², në zonën kadastrale në Gllobar, vendi i quajtur "Zabelishte", Komisioni i Ankesave, në takimin e datës 15.11.2022, mori këtë:

V e n d i m

Refuzohet si e pa bazuar ankesa përmes postes Nr. R 2590511, të datës 11.11.2022, ndërsa njoftimi i Komisionit Vlerësues për Vlerësimin e Ofertave për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për parcelën kadastrale Nr.P-70310515-00438-4, në sipërfaqe 2559 m², në zonën kadastrale në Gllobar, vendi i quajtur "Zabelishte", mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Komuna e Drenasit, respektivisht Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Drenasit, me datë 04.11.2022, ka bërë shpalljen e njoftimit publik Nr. 01-070-57805, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale.

Me datë 02.11.2022, komisioni ka bërë hapjen e ofertave për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite në komunën e Drenasit, me ofertuesit pjesëmarrës gjatë hapjes së ofertave.

Komisioni vlerësuar ka filluar me vlerësimin e ofertave me datë 04.11.2022, bazuar në Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullore (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe

Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, rrjedhimisht kriteret e përcaktuara sipas akteve të lartcekura.

Më datë 04.11.2022, Komisioni Vlerësues për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, shpall njoftimin për ofertat fituese Nr. 01-070-57805.

Ofertuesi Sabit Elshani me emrin tregtar D.P.T. Drenkos në Gllobar, ka parashtruar ankesën përmes postes Nr. R 2590511, të datës 11.11.2022, kundër dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në të cilën ka kërkuar të anulohet njoftimi i datës 04.11.2022, për parcelën kadastrale Nr.P-70310515-00438-4, në sipërfaqe 2559 m², në zonën kadastrale në Gllobar, vendi i quajtur "Zabelishte".

Komuna e Drenasit, rrjedhimisht Komisioni për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, me kohe ka publikuar të gjitha procedurat, kushtet dhe kriteret e parapara për shqyrtim me rastin e përzgjedhjes së ofertave ekonomikisht me të favorshme. Sipas komisionit të ankesave njoftimi është shpallur në përputhje me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke përfshi edhe kriteret shtesë të parapara në njoftimin publik, ashtu siç parashihet në nenin 20, nënpikën 1.1.5 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Sipas dokumentacionin ofertuesi Sabit Elshani me emrin tregtar D.P.T. Drenkos në Gllobar nuk e ka plotësuar kriterin në bazë të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës neni 4 pika 1 nënpika 1.2 (Te jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta), ku në bazë të procesverbalit nr. 003501 me nr. të protokollit 11-462-56826 te dt.01.11.2022, konstatohet se prona nuk ka qenë e lirë ndaj palëve të treta, komisioni vlerësues e kishte të pa mundur vlerësimin e ofertës së pranuar, rrjedhimisht vendimi i komisionit ishte i drejtë.

Andaj, duke pasur parasysh nga të gjitha qe u thanë me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur ka të drejtë të iniciojë kontestin administrativ në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Anëtarët e komisionit të ankesave:

- 1.Armend Hajdini
- 2.Besart Bajrami
- 3.Zeqir Hasi
- 4.Hamit Haxhiu
- 5.Kaltrina Gashi



INTERLEX ASSOCIATES

PROFESSIONAL LEGAL AND COMMERCIAL SERVICES

Për: Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme, Komuna e Drenasit/Glllogocit. Adresa Rr. "Fehmi Lladrovci" p.n., 13000 Drenas, Rep. e Kosovës.

Nga: Sabit ELSHANI, me numër personal 1175455023, drejtor dhe pronar i kompanisë me emër të biznesit "Sabit Elshani B.I" me emër tregtar "D.P.T. DRENKOS" i regjistruar në Agjencinë e regjistrimit të bizneseve të Kosovës me numrin Unik identifikues 811175571, i përfaqësuar nga "INTERLEX ASSOCIATES" L.L.C. përmes avokatit Bejtush ISUFI me adresë në rrugën "Fehmi Agani" H-138/7, 10000 Prishtinë, Rep. e Kosovës.

Lënda: Ankesë kundër Njoftimit Nr. 01-070-57805 i dt.04.11.2022

Data: 11 nëntor 2022

Objekt shqyrtimi

Njoftimi Nr. 01-070-57805 i dt. 04.11.2022, i Komisionit Vlerësues të ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.

Me këtë Njoftim, Komisioni i mësipërm kishte shqyrtuar ofertat për marrjen e tokës komunale në shfrytëzim dhe atë specifikisht me anë të së cilit për Parcelën Kadastrale nr. P-70315015-00438-4, në sipërfaqe të përgjithshme 2559m², në vendin e quajtur "Zabelishte", Zona Kadastrale Glllogar, ky Komision kishte rekomanduar: "Rishpalljen e ofertës në konkurim publik, pasi të përmbushen kriteret për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas Ligjit Nr.06/L092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me arsyetimin se "bazuar në procesverbalin 11 Nr.462-56826 datë 01.11.2022 të Drejtorisë së Inspektionit, konstatohet se prona nuk është e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta siç kërkohet me nenin 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Rregullores (ORK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, pamundësohet vlerësimi i ofertës së pranuar nga komisioni".

Provë: Njoftimi Nr. 01-070-57805 i dt. 04.11.2022.

Arsyetim

Me datë 31.10.2022, Sabit ELSHANI, me numër personal 1175455023, drejtor dhe pronar i kompanisë me emër të biznesit "Sabit Elshani B.I" me emër tregtar "D.P.T. DRENKOS" i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës me numrin Unik Identifikues 811175571, ka plotësuar formularin për aplikim për Parcelën Kadastrale nr. P-70315015-00438-4, në sipërfaqe të përgjithshme 2559m², në vendin e quajtur "Zabelishte", Zona Kadastrale Glllogar, formularit i ka bashkangjitur edhe Ofertën.

Provë: Aplikacioni për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale – Formulari për Aplikim dhe Oferta.

Siç shihet nga përmbajtja e Njoftimit Nr. 01-070-57805 i dt. 04.11.2022, aplikacioni i palës ankuese nuk është marrë fare në shqyrtim dhe Komisioni nuk ka dhënë asnjë arsyje në njoftim se pse aplikacioni nuk është marrë në shqyrtim.

Me rastin e mos shqyrtimit të aplikacionit si dhe mos dhënies së arsytimit lidhur me mos shqyrtimin e të njëjtit, Komisioni në këtë mënyrë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale administrative respektivisht nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE.

Siç shihet nga përmbajtja e Njoftimit Nr. 01-070-57805 i dt. 04.11.2022, i njëjti është marrë në kundërshtim me normat ligjore pozitive të procedurës administrative, për shkak se arsyetimi nuk i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ, ngase i njëjti është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtthënës dhe i pakuptueshëm, kështu bënë që i njëjti të jetë i barabartë me mungesën e tij.

Komisioni me rastin e shqyrtimi të ofertave nuk ka marrë në shqyrtim fare aplikacionin e palës ankuese, me këtë rast Komisioni ka bërë shkelje të të drejtave të palëve në konkurrim duke e përjashtuar në mënyrë arbitrare dhe pa asnjë arsyetim nga procesi i vlerësimit.

Propozimi

Në bazë të argumentimit juridik, shtjellimit të rrethanave faktike të çështjes, ofrimit të provave me të cilën provohen faktet e shtjelluara në ankesë i propozojmë Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme, Komuna e Drenasit/Glllogocit, që të marrë këtë:

V E N D I M

MIRATOHET, ankesa e Sabit ELSHANI, me numër personal 1175455023, drejtor dhe pronar i kompanisë me emër të biznesit “Sabit Elshani B.I” me emër tregtar “D.P.T. DRENKOS” i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës me numrin Unik identifikues 811175571, i përfaqësuar nga “INTERLEX ASSOCIATES” L.L.C. përmes avokatit Bejtush ISUFI, si e bazuar.

ANULOHET, Njoftimi Nr. 01-070-57805 i dt.04.11.2022, i marrë nga Komisioni Vlerësues i Ofertave për dhënie të pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, lënda të rikthehet në rivlerësim dhe vendosje.

Për ankuesin:

Sipas autorizimit Bejtush ISUFI, avokat
rruga “Fehmi Agani” Hyr. 138 Kati i III-të, Nr.7, Prishtinë.

Avokat
Fehmi Agani
138 Kati i III-të
Nr.7, Prishtinë
/nënshkrimi/

Bashkangjitur: 1) Prokura, 2) Njoftimi Nr. 01-070-57805 i dt. 04.11.2022 dhe 3) Aplikacioni për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale – Formulari për Aplikim dhe Oferta.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit



Nr 01-020/04-59610 dt. 15.11.2022

Komisioni i Ankesave i formuar sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr.02-020/04-49444, të datës 27.09.2022, në përputhje me Ligji Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke vendosur sipas ankesës përmes postes Nr. R 2506568 , të datës 10.11.2022, lidhur me njoftimin Publik Nr.01-462-53050, të datës 17.10.2022, për dhënie në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale, rrjedhimisht njoftimit të Komisionit Vlerësues për Vlerësimin e Ofertave për Dhënie e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për shpallje të fituesve të ofertave ekonomikisht me të favorshme Nr. 01-070-57805, të datës 04.11.2022, për parcelën kadastrale Nr.P-70310515-00438-5, në sipërfaqe 1838 m², në zonën kadastrale në Gillobar, vendi i quajtur “Zabelishte”, Komisioni i Ankesave, në takimin e datës 15.11.2022 , mori këtë:

V e n d i m

Refuzohet si e pa bazuar ankesa përmes postes Nr. R 2506568 , të datës 10.11.2022, ndërsa njoftimi i Komisionit Vlerësues për Vlerësimin e Ofertave për Dhënie e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për parcelën kadastrale Nr.P-70310515-00438-5, në sipërfaqe 1838 m², në zonën kadastrale në Gillobar, vendi i quajtur “Zabelishte”, mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Komuna e Drenasit, respektivisht Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Drenasit, me datë 04.11.2022, ka bërë shpalljen e njoftimit publik Nr. 01-070-57805, për dhënie në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale.

Me datë 02.11.2022, komisioni ka bërë hapjen e ofertave për dhënie e pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite në komunën e Drenasit, me ofertuesit pjesëmarrës gjatë hapjes së ofertave.

Komisioni vlerësues ka filluar me vlerësimin e ofertave me datë 04.11.2022, bazuar në Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullore (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënie në Shfrytëzim dhe

Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, rrjedhimisht kriteret e përcaktuara sipas akteve të lartcekura.

Më datë 04.11.2022, Komisioni Vlerësues për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, shpall njoftimin për ofertat fituese Nr. 01-070-57805.

Ofertuesi Besart Morina nga fsh.Gllobar, ka parashtruar ankesën përmes postes Nr. R 2506568 , të datës 10.11.2022, kundër dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në të cilën ka kërkuar të anulohet njoftimi i datës 04.11.2022, për parcelën kadastrale Nr.P-70310515-00438-5, në sipërfaqe 1838 m², në zonën kadastrale në Gllobar, vendi i quajtur "Zabelishte".

Komuna e Drenasit, rrjedhimisht Komisioni për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, me kohe ka publikuar të gjitha procedurat, kushtet dhe kriteret e parapara për shqyrtim me rastin e përzgjedhjes së ofertave ekonomikisht me të favorshme. Sipas komisionit të ankesave njoftimi është shpallur në përputhje me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke përfshi edhe kriteret shtesë të parapara në njoftimin publik, ashtu siç parashihet në nenin 20, nënpikën 1.1.5 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Sipas dokumentacionin ofertuesi Besart Morina nga fsh. Gllobar nuk e ka plotësuar kriterin në bazë të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës neni 4 pika 1 nënpika 1.2 (Te jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta), ku në bazë të procesverbalit nr. 003503 me nr. të protokollit 11-462-56826 te dt.01.11.2022, konstatohet se prona nuk ka qenë e lirë ndaj palëve të treta, komisioni vlerësues e kishte të pa mundur vlerësimin e ofertës së pranuar, rrjedhimisht vendimi i komisionit ishte i drejtë.

Andaj, duke pasur parasysh nga të gjitha qe u thanë me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur ka të drejtë të iniciojë kontestin administrativ në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Anëtarët e komisionit të ankesave

- 1.Armend Hajdini
- 2.Besart Bajrami
- 3.Zeqir Hasi
- 4.Hamit Haxhiu
- 5.Kaltrina Gashi





Avokat: GAZMEND HALILAJ
Rr. "F.XH Lladrovci", Glllogoc
Tel: +377 (0) 44 -312-345
Gazmend.halilaj81@gmail.com



Nr. 01-070-57805

KOMUNËS SË GLLLOGOCIT

KOMISIONIT TË ANKESAVE

PREJ: z.Besart Morina nga i ati Mustaf,i lindur me 16.08.1989 nga fshati Glllobar KK-Glllogoc, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Gazmend Halilaj – avokat-.

ÇESHTJA JURIDIKE: Anulim i vendimit Nr.01-070-57805 i dt. 04.11.2022 përkitazi më palujtëshmerinë e evidentuar me Nr. kadastral: P-70315015-00438-5

Kundër vendimit të Komunës së Glllogocit, vendim ky i evidentuar me numër si më lartë ashtu që e dëmtuari përmes të autorizuarit paraqet këtë:

ANKESË

Për shkak të:

- Vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjës faktike
- Shkelje e dispozitave materiale

Me propozim që: organi shqyrtues i ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, bazuar në Ligjin 06L-092 të bie:

AKTVENDIM

me të cilin:

I. - Aprovohet ankesa e parashtruesit z.Besart-Morina si tërsisht e bazuar.

II. - Shfuqizohet Vendimi Nr.01-070-57805 i dt. 04.11.2022 përkitazi më palujtëshmerinë e evidentuar me Nr kadastral: P-70315015-00438-5 dhe

-III- Pranohet ankesa e z.Besart Morina ashtu që NDRYSHOHET Vendimi i Komunës Glllogoc. Nr. 01-070-57805



Avokat: GAZMEND HALILAJ
Rr. "F.XH Lladrovci", Gllogoc
Tel. +377 (0) 44 -312-345
Gazmend.halilaj81@gmail.com

i datës 04.11.2022 duke ia njohur parashtruesit të kësaj ankesë të drejtën e shfrytëzimit të kësaj parcele për periudhën kohore prej (99) vjet.

I. ARSYETIM: Të ndëruar, parashtruesi i kësaj ankesë kishte aplikuar sipas procedurave ligjore duke i'u nënshtruar të gjitha procedurave të përcaktuara nga organi kompetent, dhe natyrisht kishte arritur të plotësoj të gjitha kriteret e përcaktuar aq me tepër në raport e konkurentin tjetër.

II. Mirëpo, edhe për kundër plotësimit të të gjitha kriterëve, Komuna Gllogoc në minutat apo sekondat e fundit para mbylljes së konkursit ka dërguar një Komision nga Drejtoria e Inspeksionit i cili kishtë shkuar për vizitë tek palujtëshmeria e lartë cekur dhe përmes procesverbalit të evidentuar me numër serik: 003503 „pa numër të protokolit,, me një datë të përmirsuar-zhgallavitur- ku kanë konstatuar se: në parcelën me numër 004388-5ZK Gillobar ka të ndërtuar objektin me sipërfaqe përafërsisht prej 3 ari. Në këtë objekt ushtron veprimtarinë si objekt afaristt „NTP BESI,, shitje me pakicë teknike-mbaroj citimin.

III. Ndërsa sipas Njoftimit të kesaj Komunë parashtrusit të kësaj ankesë i është refuzuar kërkesa lidhur me marrjen në shfrytëzim të kësaj palujtëshmerie e sipas këtij njoftimit për faktin se: për parcelën Kadastrale Nr.P-70315015-00438-5, në sipërfaqe të përgjithshme 1838 metër katror, në vendin e quajtur " Zabëlisht" Zona kadastrale Gillobarë, bazuar në procesverbalin Nr. 11-nr.462-56826 të datës 01.11.2022,t ë Drejtorisë së Inspeksionit konstatohet se: prona nuk është e lirë ndaj obligimeve të palës se tretë siç theksohet ne nenin 4. paragrafi 1. nën paragrafi 1.2 të rregullores (QRK) Nr.09/20, për përcaktimin e procedurave të dhenjës në shfrytëzim dhe këmbim të pronës se paluajtëshme të Komunës, pamundësohet vlerësimi i ofertës së pranuar të Komisionit dhe rekomandohet rishpallja për konkursin publik-mbaroj citimin.

PRETENDIMET E MBROJTJES SI NË VIJIM

Një e metë e tillë e vendimit të atakuar paraqet shkelje esenciale të dispozitave imperative të procedurës së aplikueshme.



Avokat: GAZMEND HALILAJ
Rr. "F.XH Lladrovci", Glllogoc
Tel. +377 (0) 44 -312-345
Gazmend.halilaj81@gmail.com



Sepse vendimi i atakuar është marrë në kundërshtim me procedurën dhe rregullat e aplikueshme sepse formulimi i tij është teje i manget, nuk është i kuptueshem, është i pakjartë edhe hartimi i tij është bërë në formë formulari pa treguar mbi arsyet vendimtare „dhe bazen ligjore,, se tek te cilat është mbështetur për të ardhur në përfundim lidhur me refuzimin e kërkesës së parashtruesit. Derisa në bazë të ligjeve të aplikeushme vendimi duhet të jetë i kjartë, i kuptueshem, ndërsa vendimi në bazë të hartimit duhet të ketë hyrjen, dispozitivin, arsyetimin dhe këshillimin juridik, ndërsa forma e tij nuk është në pajtim me dispozitat dhe si i tillë nuk mundë të qëndroj sepse i mungon pjesa arsyetuese, respektivisht pjesa arsyetuese ekziston, por i mungon në menyrë të plotë një arsyetim i duhur i cili patjetër duhet të tregoj tërë rrjedhën prej që është paraqitur kërkesa mënyrën se si ka rrjedhur ngjarja, përbërjen e komisionit, ekzaminimin e fakteve kontestuese, me konkretisht cilat fakte i ka administruar cilat jo dhe cilave i'a ka falur besimin, cilat i ka refuzuar dhe të japin arsye pse i'a ka falur besimin dhe pse i ka refuzuar po ashtu të bëjë në vlerësim të gjendjes së saj se, deri në çfarë shkallë i ka plotësuar kushtet për njohjen e kësaj të drejtë, e në rastin konkret një gjë e tillë në vendimin e atakuar FARE NUK EKZISTON.

Për me tepër arsyet e parashtruara në vendimin e atakuar janë të tilla vetëm nga nocioni dhe emertimi e në të vërtet janë thjeshtë vetëm përshkrim i procedurës së zhvilluar me rastin e këtij procesi, të dhëna në një formular pa kurfarë vlerësimi apo konkludimi lidhur me faktet dhe provat e parashtruara dhe të bashkangjitura në kërkesë.

Aq me tepër i terë njofimi mbështetët kinse parashtuesi z-Basart Morina, nuk e ka liruar parcelën për të pasur qasje personat e tretë, mirëpo shtrohet pyejta: kush e ka obliguar paraprakisht parashtruesin për një gjë të tillë, nese do të duhej të lirohet prona në terësi, atëherë pse nuk kemi një inspektim para se të dalin ofertat për të rrenuar qdo objekt aty, e nese në afaitn e caktuar shfrytëzuesi nuk e benë, atëherë vetë Komuna përmes ndonjë firme adekuate të bejë lirimn e pronës duke respektuar procedurat strikte siq parashihe me ligjin përkates, gjegjësisht ligjin për ndertim.

Por, krjet kjo është berë nga ana e Komisionit pa asnjë kërkesë apo njoftim paraprak qe parashtruesi duhet të liroj në terësi parcelën, andaj shtrohet pyejta si mund ti refuzohet të njëjtit një kekresë e tillë derisa nuk i është kërkuar paraprakisht një gjë e tillë, aq me tepër kur nuk kemi asnjë provë qe



Avokat: GAZMEND HALILAJ
Rr. "F.XH Lladrovci", Glllogoc
Tel. +377 (0) 44 312 345
Gazmend.halilaj81@gmail.com

Me këtë unë Besart Morina i lindur me dt. 16.08.1989 në fshatin Glllobar KK-Glllogoc, i cili posedoj dokument të identifikimit me numër 1177788810 të leshuar nga MPB-Kosovë, ndersa me dt. 10.11.2022, jepi këtë :

A U T O R I Z I M

AUTORIZOHET avokati **Gazmend Halilaj** nga Glllogoci, me nr. ID-së 1452/16, të dhënë nga Oda e Avokatve të Kosovës, me zyrë Glllogoc, Rr. "Fehmi Xhevë Lladrovci" që mund t'kryej të gjitha veprimet në procedurë, në lidhje me lënden e evidentuar pranë Komunes Glllogoc dhe çdo institucioni tjetër lidhur me pronën që gjëndet në fshatin Glllobar me numër 0438-5 zona kadastrale Glllogoc.

Sipas nevojës këtë autorizim i autorizuari mund ta bartë pjesërisht apo në tërësi në personin e tretë, e sipas zgjedhjes së tij. Autorizimi i dhënë në formë të shkruar, mund të revokohet vetëm në këtë formë.

Dhënësi i autorizimit
Besart Morina
1177788810

Marrësi i autorizimit
Gazmend Halilaj - Avokat



Avokat: GAZMEND HALILAJ
Rr. "F.XH Lladrovci", Glllogoc
Tel. +377 (0) 44 -312-345
Gazmend.halilaj81@gmail.com

Me këtë unë Besart Morina i lindur me dt. 16.08.1989 në fshatin Glllobar KK-Glllogoc, i cili posedoj dokument të identifikimit me numër 1177788810 të leshuar nga MPB-Kosovë, ndersa me dt. 10.11.2022, jepi këtë :

A U T O R I Z I M

AUTORIZOHET avokati **Gazmend Halilaj** nga Glllogoci, me nr. ID-së 1452/16, të dhënë nga Oda e Avokatve të Kosovës, me zyrë Glllogoc, Rr. "Fehmi Xhevë Lladrovci" që mund t'kryej të gjitha veprimet në procedurë, në lidhje me lëndën e evidentuar pranë Komunes Glllogoc dhe çdo institucioni tjetër lidhur me pronën që gjëndet në fshatin Glllobar me numër 0438-5 zona kadastrale Glllogoc.

Sipas nevojës këtë autorizim i autorizuari mund ta bartë pjesërisht apo në tërësi në personin e tretë, e sipas zgjedhjes së tij. Autorizimi i dhënë në formë të shkruar, mund të revokohet vetëm në këtë formë.

Dhënësi i autorizimit
Besart Morina
1177788810

Marrësi i autorizimit
Gazmend Halilaj - Avokat-

